



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 28 shkurt 2022 në mbledhjen e VI-të (gjashtë), të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, përveç z.Gazmend Islami, i cili mungoi.

Gjithashtu në mbledhje i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive (DBF, DPZHE, DPKGJ, DKA, DPUMM, DSHPMSh, DBPZHR, DA, DSHMS)

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe përfaqësues të mediave lokale dhe më gjerë, përfaqësues të OJQ-SDK, disa zyrtar komunal dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndeti të pranishmit, ndër të tjera theksoi, në bazë të listës së nënshkrimeve të pranishëm në sallë janë 33 anëtar/e të Kuvendit ndërsa për momentin mungojnë 2, andaj kuorumi ekziston për të vazhduar me mbledhjen.

Sigurisht jeni në dijeni që disa prej ish këshilltarëve të Kuvendit të Komunës kanë dhënë dorëheqja nga cilësia e anëtarit të Kuvendit pasi që janë emëruar në pozita ekzekutive. Për të njëjtit janë zhvilluar procedurat në KQZ për zëvendësimin e tyre sipas rregullativës ligjore në fuqi, për çka KQZ ka bërë zëvendësimin e anëtarëve në fjalë, përkatësisht janë nxjerrë vendimet sipas të cilave Fatri Zhitija është zëvendësuar nga Ardi Hasani, Avni Fetahu është zëvendësuar nga Ragip Fetahu, Bahri Selimi është zëvendësuar nga Haki Rudari, Vigan Salihu është zëvendësuar nga Bahri Blakçori dhe Pajtim Balaj është zëvendësuar nga Xhevdet Maloku.

Tani para se anëtarët e cekur të japin betimin solemn, ftoj Komisionin për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit znj.Donjetë Sheqiri, znj.Sebastina Vokrri dhe znj.Endritë Murati, të verifikojnë mandatet e të përmendurve dhe të paraqesin raportin përkatës.

znj.Sebastina Vokrri, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit e paraqiti raportin e verifikimit, theksoi, si komision analizuam dokumentacionet përkatëse të KQZ-së për zëvendësimin e 5 anëtarëve të Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, dhe tani sipas radhës thërras me emër anëtarët e emëruar nga KQZ.

z.Ardi Hasani emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Fatri Zhitija, obligohet sekretariati i KQZ-së që këtë vendim t'ia komunikoj z.Ardi Hasanit si dhe të ndërmerren veprime procedurale për zbatim.

z.Haki Rudari emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Bahri Selimi.

z.Ragip Fetahu emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Avni Fetahu.

z.Bahri Blakçori emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Vigan Salihu.

z.Xhevdet Maloku emërohet anëtar i Kuvendit komunal në Podujevë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit komunal z.Pajtim Balaj.

Pra konsiderojmë se çdo gjë është në rregull për dhënien e betimit nga të emëruarit, të cilëve i'u urojmë suksese.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, në bazë të raportit të Komisionit përkatës u konstatua se çdo gjë është në rregull dhe mund të vazhdohet më tutje.

Tani ftoj anëtarët e emëruar të ngritën në këmbë për dhënien e betimit. Sa për rikujtim, unë e lexoj me zë tekstin e betimit, kurse nga ana juaj përsëritet i njëjti tekst me të vetmin plotësim që pas fjalën Unë, secili prej juve e përmend emrin e vet, kurse tekstin tjetër e përsëritni pjesë pjesë.

Me tekstin në vijim:

“Unë, (duke e përmendur secili emrin dhe mbiemrin e tij) betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

z.Ardi Hasani, z.Ragip Fetahu, z.Haki Rudari, z.Bahri Blakçori dhe z.Xhevdet Maloku, japin betimin dhe nënshkruajnë deklaratën e betimit

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urime të nderuar tani edhe zyrtarisht jeni këshilltar të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, me mbledhjen duke theksuar, dihet se për këtë mbledhje janë paraparë më shumë pika të rendit të ditës se herëve tjera, mirëpo besoj se do të përfundoj në mënyrë të duhur. Vlen të theksohet se përveç pikave të parapara me thirrjen e kësaj mbledhje, në Komitetin për Politikë dhe Financa janë dhënë edhe disa rekomandime për Kuvendin e Komunës, përkatësisht janë futur edhe 3 pika shtesë dhe janë rekomanduar Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, kërkoj që pika e renditur në nr.16 sipas rekomandimeve të KPF-së, të tërhiqet nga rendi i ditës, përkatësisht të mos përfshihet në rendin e ditës së kësaj mbledhje të Kuvendit. Në koordinim me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik u dakorduam se në një seancë sa më të afërt Drejtoria në fjalë të sjellë një dokument draft Rregullore të re për orarin e punës së bizneseve, andaj kërkoj që pika e cekur të tërhiqet dhe të mos përfshihet fare në rend të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra e hedh në votim kërkesën e parafolësit si iniciues në KPF i pikës në fjalë, por që tani kërkon të tërhiqet ajo pikë dhe të mos përfshihet në rend të ditës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u mbështet kërkesa për tërheqjen e propozimit të pikës së rendit të ditës të rekomanduar me konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, dhe atë:

•Propozim për pezullimin e dispozitave të nenit 5 paragrafët 1.3; 2.3 dhe 4.4, nenit 6 paragrafi 4, nenit 7 paragrafi 2, nenit 9 paragrafi 1.3, nenit 12 paragrafi 2, nenit 15 paragrafi 2.4, nenit 16 paragrafi 2.3, dhe nenit 17 paragrafi 2 të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31.01. 2020, sipas model-vendimit të njëjtë me atë të vitit 2021, me të vetmin ndryshim që pezullimi i neneve të cekura të bëhet deri në nxjerrjen e Rregullores së re.

z.Naim Çunaku, theksoi, kjo që do të them kërkoj të merret si sugjerim, jo si kundërshtim. Ne e filluam këtë mbledhje pa hyrë në rend të ditës dhe pa e votuar atë, pra para se ta lexoni rendin e ditës i nderuar Kryesues dhe para se të votohet, hytë në votim për çështje tjera, prandaj kërkoj që ta lexoni rendin e ditës, ta hedhësh në votim, pastaj na jepet rasti të marrim fjalën dhe të deklarojemi se kush është për e kush kundër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa për sqarim të parafolësit, unë e paraqita rendin e ditës, mirëpo para se ta hedh në votim këshilltari Bashkim Syla kërkoj që të tërhiqet një pikë e rekomanduar për këtë rend dite, kështu që konsideroj se në rregull jemi. Unë hyra në rend të ditës, sqarova se thirrja dhe materiali ju është përcjellë me kohë, po ashtu edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 25.02.2022, nga e cila kanë dal edhe tri pika shtesë e që njëra prej tyre ishte propozimi i këshilltarit z.Bashkim Syla i cili tani kërkoj që të tërhiqet nga rendi i ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, lexojeni rendin e ditës sipas thirrjes, pastaj sqaroheni se kemi 3 rekomandime nga KPF për plotësim të rendit të ditës, dhe kur vijmë në atë fazë atëherë mund të hapet debat rreth tërheqjes së ndonjë pike apo çështje të ngjashme.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se nuk kemi çfarë e zgjasim me gjëra të tilla, kemi rendin e propozuar të ditës, rekomandimet e KPF-së, pastaj propozimi i rekomanduar nga këshilltari Bashkim Syla veç i mori votat që të tërhiqet, andaj na mbetet vetëm ta hedhim në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe rekomandimeve të KPF-së.

z.Arjant Topanica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së jemi kundër këtij rendi të ditës, më saktësisht për pikën e parafundit që është propozimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, për të cilën nuk mendoj se është e logjikshme dhe e arsyeshme që t'i propozohet Kuvendit diçka për të cilën ne nuk e kemi materialin e propozim planit të punës, dhe unë si pjesë e këtij Grupi nuk e kam versionin iniciues të këtij plani, e që mendoj se fillimisht do të duhej që të ishte në duart tona si anëtar të Kuvendit që ta shikojmë dhe ta shqyrtojmë, dhe mandej të sjellët si version final për propozim para Kuvendit të Komunës.

Do të thotë ne jemi që pika e rendit të ditës që është propozimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, të mos përfshihet në rend të ditës dhe të shtyhet për një mbledhje tjetër të radhës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, materiali i të gjitha pikave të rendit të ditës, përfshirë edhe propozim planin e punës së Kuvendit besoj ju është dërguar të gjithëve përmes e-maileve, dhe për këtë këtu kemi zyrtarin përkatës i cili mund ta verifikoj këtë sepse unë e kam parë që materiali në fjalë është përcjellë përmes konstatimeve të rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Arjant Topanica, theksoi, nuk kemi pranuar plan të punës për vitin 2022, madje unë ju kam kërkuar edhe përmes e-mailit i nderuar Kryesues dhe më keni thënë që posa të jetë i gatshëm do t'ju përcillet.

z.Fitim Muçolli, theksoi, propozim planin e punës së Kuvendit për vitin 2022 e keni në e-maile që ju është dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhje e KPF-së dhe mund ta shikoni atë.

z.Naim Çunaku, theksoi, u mundova të jap një qasje se si duhet të menaxhohet dhe udhëhiqet një seancë e Kuvendit. U potencua se nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa janë rekomanduar edhe 3 pika shtesë, e vërteta është që rreth pikës me të cilën i ndahen mjete financiare Ndërmarrjes Publike KRM "Pastrimi" me unanimitet e përkrahëm, ndërsa për 2 pikat tjera të cilat edhe sot po kundërshtohen, i kemi kundërshtuar edhe në mbledhjen e KPF-së, për të cilat është thënë edhe në KPF por po e them edhe sot këtu që duhet të bëjmë përpjekje që mbledhjet e Kuvendit të Komunës të thirren në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, Statutit të Komunës dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale. Pra edhe në KPF e kam thënë dhe po e përsërisë edhe këtu që nuk mund të caktohet në një mbledhje ndonjë pikë e rëndësishme së veçantë pa pasur një urgjencë, siç ishte pika rreth pezullimit të disa neneve të rregullores së orarit të punës së bizneseve ku edhe në KPF e kam thënë se si është e mundur të përfshihet një pikë shtesë pa pasur material por vetëm duke i lexuar disa nene dhe me atë të tërhiqet një rregullore e cila e ka munduar Kuvendin për më shumë se dy vite sepse është bërë gjithçka me të, por vetëm Rregullore s'ka mbet, andaj në KPF e propozova që kjo pikë duhet të trajtohet si pikë e veçantë e rendit të ditës në një mbledhje dhe ta nxjerrim një rregullore të mirëfilltë për të cilën do gjenim gjuhën e përbashkët

qoftë për rregulloren që do e miratonim qoftë edhe duke mos e dëmtuar asnjë biznes në Komunën e Podujevës.

Ndërsa sa i përket pikës për të cilën foli kolegu z.Arjant Topanica që është propozim plani i punës Kuvendit për vitin 2022, është e vërtetë e madhe se tani kjo “loja” që tani mund të thuhet se e keni apo jo në materialin e dërguar, atë secili prej neve mund ta kemi vetëm pas të shtunës, ndërsa materiali i një pike të rregullt të rendit të ditës dihet sa ditë përpara duhet t’ju dërgohet anëtarëve të Kuvendit, kurse një plan i punës i cili i jep rëndësinë që e ka Kuvendi i Komunës, të trajtohet me urgjencë dhe t’i lëshohet (dërgohet) materiali për 2 ditë, atë e kemi kundërshtuar dhe e kundërshtojmë edhe sot ngase një propozim plan i punës duhet të hartohet dhe të sjellët dhe të debatohet në një mbledhje të rregullt në mënyrë që t’i krijohet hapësirë secilit anëtar të Kuvendit të jap kontributin e tij për temat që mendohet se duhet të shtjellohen brenda një viti në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së keni qenë kundër, por ajo pikë ka kaluar me shumicë dhe është pjesë e rendit të ditës për këtë mbledhje.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë e potencova atë që Kryesuesi po e thotë, mirëpo tani po kërkon të tërhiqet njëra prej atyre 3 pikave që kanë hyrë në KPF, dhe atë ashtu siç kemi propozuar ne.

Kryesuesi i Kuvendit, (i drejtohet parafolësit z.Naim Çunakut), theksoi, ndoshta e zgjate paksa sepse për një çështje ke të drejtë të merrni fjalën vetëm njëherë, jo 3-4 herë, kështu që edhe ti i nderuar jeni duke shkel Rregulloren e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë e kam lexuar Rregulloren e punës së Kuvendit dhe mund t’ju lexoj edhe juve sepse Rregullorja ma lejon që sa herë ka tentim për shkelje të Rregulloreve unë mund të marrë fjalën, dhe kjo nuk është e përcaktuar sipas vullnetit tuaj 1,2 apo 5 herë.

z.Fitim Muçolli, theksoi, sa i përket propozim planit të punës së Kuvendit ju informoj se ne si Grup punues duke përfshirë edhe anëtarin e juaj nga radhët e LDK-së, kemi qenë në takim dhe kemi hartuar draftin e planit të punës, dokument i cili ju dërguar në e-mail dhe mund ta gjeni, andaj nuk e di përse po thuhet se nuk është në e-mail sepse është diçka evidente dhe e shkruar, për çka mund ta pyesni anëtarin e juaj.

z.Arjant Topanica, theksoi, është e vërtetë se unë kam qenë prezent por kanë qenë vetëm diskutime apo siç mund të thuhet vetëm fjalë goje, mirëpo pasi që të dërgohet në formë fizike duhet edhe të krijohet hapësirë që ne të diskutojmë bashkërisht brenda Grupeve, gjë që nuk është e mundur që brenda dy ditëve të vikendit të diskutohet dhe të propozohet për Kuvend menjëherë pas dy ditëve një propozim plan i punës, pa krijuar hapësirë për propozime të reja nga Grupet e këshilltarëve, prandaj e them se janë të papranueshme që për dy ditë të vikendit të dërgohet materiali dhe të votohet menjëherë sot. Pra nuk jemi kundër një plani të punës së Kuvendit, por vetëm të shtyhet për një seancë tjetër të radhës në mënyrë që të na jepet mundësia ta shqyrtojmë, dhe të vijmë deri te një version final për miratim, por nuk konsideroj se ka ndonjë urgjencë që ai plan të votohet sot, vetëm pas 2 ditëve që na është dërguar në formë elektronike.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, parafolësi ka qenë anëtar i Grupit punues, konsideroj se ky plan i punës ka urgjencë sepse hartohet për 12 muaj të vitit, kurse neve si Kuvend 2 muaj veç se na ka ikur, prandaj unë nuk e di se dalim para opinionit dhe para qytetarëve me punime të Kuvendit pa plan të punës, kështu që është një prej kërkesave të Kuvendit dhe të drejtorëve të Ekzekutivit, ndërsa jemi në dijeni se deri tani ka pas vonesa për sjelljen e planit të punës për arsye se edhe drejtorët nuk kanë qenë të emëruar, dhe tani në bashkëpunim edhe me drejtorët është përgatitur edhe ky propozim plan. Përndryshe ne mund ta hedhin në votim edhe këtë çështje dhe nëse jeni për ta shtyrë për një mbledhje tjetër të radhës, në rregull është, unë personalisht nuk jam për një gjë të tillë, mirëpo nëse shumica e anëtarëve të Kuvendit janë për, unë e mbështesë qëndrimin.

Unë e hedh në votim, kush është për, që propozim plani i punës së Kuvendit të hiqet nga rendi i ditës, përkatësisht të mos përfshihet në rend të ditës për këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se meqë 13 vota ishin PËR, 19 vota KUNDËR, dhe asnjë votë e përmbajtur, nuk mbështetet kërkesa për mos përfshirje në rend të ditës propozim Planit i punës së Kuvendit për vitin 2022, sipas rekomandimeve të konstatuara në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, sipas rezultatit të votimit propozim plani i punës së Kuvendit për vitin 2022 mbetet pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje, andaj secili që ka propozime, kërkesa apo vërejtje mund t'i paraqet gjatë shqyrtimit kur t'i vie radha.

Tani e hedh në votim komplet rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës për këtë mbledhje, përfshirë edhe 2 nga 3 pikat shtesë të rekomanduara nga Komiteti për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 20 vota PËR, 13 vota KUNDËR dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet rendi i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të kësaj mbledhje, përfshirë e dhe 2 nga 3 pikat shtesë të rekomanduara për këtë mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa. Rendi i miratuar i ditës është;

- 1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29.12.2021 ; 14.01.2022.*
- 2. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.*
- 3. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a.*
- 4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.*
- 5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë.*
- 6. Propozim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete.*
- 7. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.*
 - Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.*
- 8. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative - arsimore të Komunës së Podujevës*
 - Propozim vendimi për vënien në diskutim publik.*
- 9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës.*
- 10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë.*
- 11. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor të shkollave.*
- 12. Propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike.*
- 13. Propozim vendimi për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës.*
- 14. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018.*
- 15. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM "Pastrimi" Sh.A.*
- 16. Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022.*
- 17. Të ndryshme.*

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29.12.2021 dhe 14.01.2022

Pas votimit, njëzëri u konstatua se pa vërejtje, apo plotësim ndryshime, miratohen procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 29.12.2021 dhe 14.01.2022

2. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022

znj. Bahrije Mehmeti, drejtore e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, mbështetur në Ligjin 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronave të paluajtshme të Komunës, përkatësisht neneve 5,6 dhe 13, Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe mbështetur në njoftimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, ku për arsye të mbajtjes së zgjedhjeve lokale me 17 tetor 2021, i'u ka pamundësuar Komunave publikimi i listës së veçantë të pronave të Komunës, njoftim sipas të cilit na është mundësuar afati që deri më 31 mars 2022 komunat t'i publikojnë Listën në fjalë. Gjithashtu meqë me pikën e rendit të ditës jeni të njoftuar dhe besoj se materialin e keni marrë të gjithë me kohë, ju propozoj që ta miratoni Listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022, sipas legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi pasi që konsiderojmë se kjo është në të mirë të qytetarëve dhe në të mirë të Komunës, andaj shpresoj se do gjejë mirëkuptimin e juaj pasi që kjo çështje është e drejtë dhe e mirë e përgjithshme si dhe e drejtë ligjore për qytetarët e Komunës së Podujevës, prandaj përmes votës tuaj t'jua mundësojmë qytetarëve që në mënyrë të ligjshme dhe transparente ta marrin pronën komunale në shfrytëzim pas miratimit paraprak po nga ana juaj si Kuvend.

z. Ilir Koprani, theksoi, propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022, është dokument i rëndësisë së veçantë dhe në interes publik. Meqë drejtoresha e DPKGJ është konsultuar me nivelin qendror se deri më 31 mars 2022 mund të bëhet publikimi i listës në fjalë, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së do ta përkrahim dhe do të votojmë për.

z. Florent Hasani, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LVV-së, duke ditur rëndësinë e interesit për përfitimet publike dhe zhvillimit ekonomik të Komunës, e mbështet propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022.

Megjithatë kërkojmë që ky proces të zhvillohet në përputhje të plotë me Ligjin për vetëqeverisje lokale duke i'u referuar 5 neneve, posaçërisht nenit 2 ku obligohet të përfshihen të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin e pronës dhe t'u përbehen afateve kohore të parapara me nene.

z. Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së jemi për, miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim.

z. Haki Rudari, theksoi, e potencoj edhe përfaqësuesi i Grupit të LVV-së se ardhja e kësaj pike të rendit të ditës për ne është shumë e pranueshme dhe shumë pozitive ngase përmes kësaj liste në një mënyrë bëhet një lloj transparence, por ajo që unë kërkoj nga Drejtoria përkatëse është që në të ardhmen të na sjellët edhe një listë e shfrytëzuesve të pronës komunale për vitet e shkuara, qoftë për vitin 2021 qoftë edhe për vitet paraprake. Këtë e them nga përvoja sepse ka pasë njerëz që e

kanë shfrytëzuar pronën komunale, kanë pasë borxhe ndaj pronës komunale dhe sërish kanë tentuar të marrin në shfrytëzim pronën komunale, gjë e cila për mua është e papranueshme, prandaj duke e rritur transparencën dhe llogaridhënien unë bazohem edhe në Ligjin përkatës ku në nenin 4 ku thuhet parimet e dhënies së pronës së paluajtshme janë; *parimi i ligjshmërisë, parimi i efikasitetit, parimi i transparencës që unë po dëshiroj ta kërkoj, pastaj parimi i ruajtjes dhe garantimit të interesit publik, parimi i ruajtjes dhe rritjes së vlerës komunale dhe parimi i ruajtjes së mjedisit*, e që realisht kemi shumë raste ku ka shumë kompani që e ndotin mjedisin, e kanë ndotë mjedisin në të kaluarën dhe kanë ecë, prandaj në këtë drejtim kërkoj që në të ardhmen të na sjellët edhe një listë e shfrytëzuesve të pronës komunale nga ish pronarët apo kompanitë e ndryshme në mënyrë që të shohim cilat janë obligimet e tyre ndaj Komunës, a i kanë kryer obligimet dhe a kanë borxhe.

z.Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë e madhe që si në çdo Komunë edhe Komuna jonë ka pas probleme me pronën komunale, kur e them fjalën probleme, fjala është për shfrytëzuesit jo kompetent të pronave, dhe një prej detyrave kryesore të një Komune është që të kujdeset për pronën e saj. E mbështesë atë që e potencoj kolegu parafolës sepse për një qeverisje të mirë, një prej kushteve të saj është transparenca.

Disa nga të pranishmit këtu janë dëshmitar që unë edhe në të kaluarën kam kërkuar vazhdimisht që pronat komunale të jenë publike për çdo qytetarë të Komunës së Podujevës i cili dëshiron t'i shoh. Shumë prej Komunave të Kosovës i kanë të publikuara në ueb-faqen e komunës të gjitha pronat, qofshin ato që shfrytëzohen me autorizim, qofshin pa autorizim, mirëpo prona komunale duhet të jetë e shenjëzuar si pronë komunale dhe në këtë e kërkojmë, fundja ka qenë një premtim elektorale i të gjitha subjekteve që kanë marrë pjesë në procesin e zgjedhjeve ku të paktën nga ajo që kam përcjellë është thënë se brenda një afati tre mujor të gjitha do të publikohen në ueb-faqen e Komunës, prandaj unë mendoj se është mirë që, jo vetëm ato që kërkoj kolegu parafolës z.Haki Rudari, por të gjitha pronat komunale që i ka në posedim Komuna e Podujevës të vëhen në ueb-faqen e Komunës dhe t'iu përngjajnë një menaxhimi çfarë ish dashtë ta bëjë Komuna me pronën e vet.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri (me 33 vota sa ishin prezent) miratohet propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2022, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” sh.a.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me formimin e një komisioni prej 3 anëtarëve nga të cilët 2 anëtarë i propozon dhe emëron Kuvendi i Komunës, ndërsa 1 anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës, kështu që urdhëroni mund ta merrni fjalën dhe të jepni propozimet.

z.Valon Demolli, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së, për anëtar në komisionin sipas këtij propozim vendimi, propozojmë z.Ekrem Rrahmanin

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, propozojmë znj.Drita Pajaziti.

znj.Endritë Murati, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozojmë znj.Mimoza Abdullahu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi të bëjmë me emërimin e 2 anëtarëve nga radhët e Kuvendit të Komunës, andaj meqë kemi 3 anëtar të propozuar na duhet që t'i hedhim në votim një nga një propozimet e dhëna.

Pra fillojmë me procesin e votimit sipas paraqitjes së propozimeve.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, 15 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë z.Ekrem Rrahmani.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, 17 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë znj.Drita Pajaziti.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, 17 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë znj.Mimoza Abdullahu.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pra në bazë të rezultateve të votimit Ekrem Rrahmani ka marrë 15 vota, Drita Pajaziti 17 vota dhe Mimoza Abdullahu 17 vota, andaj 2 anëtarët e propozuar që kanë marrë më shumë vota zgjedhën anëtar të Komisionit në fjalë, mirëpo për procedurë duhet të hedhim në votim sërish 2 komisionin me emrat e propozuar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 32 anëtar të Kuvendit sa ishin prezent për momentin në sallë, me 17 vota PËR, 15 vota KUNDËR dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, përkatësisht nga radhët e Kuvendit të Komunës emërohen znj.Drita Pajaziti dhe znj.Mimoza Abdullahu.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë formë të votimit nuk e kam parë në rregullore e as askund tjetër, por të anashkalohet Grupi më i madh i këshilltarëve duke përdorur arrogancën e numrave, të merret kandidat tjetër, më duket jo në rregull, edhe pse unë e respektoj vendimin e Kuvendit, mirëpo telashe është se në rast se votuan për Ekrem Rrahmanin 15, kurse për kandidatin tjetër 17 vota, shtrohet pyetja ku u gjinden edhe ata 17 tjerë sepse kur janë në garë dhe votohet për një kandidat, nuk votohet pro i njëjti kandidat i radhës.

4. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me të njëjtën procedurë sikurse për pikën paraprake.

z.Valon Demolli, theksoi, konsideroj se neve si Grup më i madh në këtë Kuvend na takon ta kemi një anëtar sikurse që ishte në pikën paraprake të rendit të ditës edhe përkundër mënyrës se si vepruat me votim veç e veç. Ndërsa nëse shkojmë sërish me të njëjtën mënyrë dhe nëse kemi propozim ne, sërish nuk kalon anëtari i propozuar nga ne. Nuk e di me çfarë rregulloreje jeni duke punuar i nderuar Kryesues.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk kemi të bëjmë me përfaqësim të partive politike dhe nuk ceket në rregullore që duhet të jetë përfaqësues i një subjekti politik, anëtar në këtë komision zgjedhet ai që merr votat, andaj për këtë nuk e di çfarë mund të themi sepse është vullnet i Kuvendit dhe unë nuk mund të ndërhyjë në këtë vullnet.

znj.Edona Shabani, theksoi, nëse është ashtu siç e potencuat ju Kryesues se nuk bëhet fjalë për parti politike, atëherë përse kandidati jon i pati 15 vota, kurse 2 kandidatët tjerë i patën nga 17 vota, pra si ka mundësi kjo nëse nuk është në pyetje partia.

z.Haki Rudari, theksoi, sa i përket asaj që u tha nga njeri prej parafolësve, sipas Rregullores së punës së Kuvendit në momentin kur janë 3 propozime e që fjala është sikurse në rastin që patëm, atëherë shkohet me votim veç e veç, pra vetëm desha t'jua rikujtoj se këtë e parasheh Rregullorja. Pra në këtë rast ne patëm 3 propozime, andaj edhe u dashtë të shkohet në votime veç e veç për secilin kandidat të propozuar, jo që po e them unë por këtë e thotë Rregullorja e cekur, megjithatë unë e kam thënë edhe në mbledhjen e Grupit të LVV-së dhe po e them tani edhe këtu, është dashtë që paraprakisht ta kemi edhe një konsensus, pajtohem në një mënyrë se nuk janë domosdoshmërisht numrat (votat), pro në këtë rast do të lusja që ndoshta shefat e Grupeve të arrijnë një konsensus në një mënyrë që sa do ku do të përfaqësohet edhe opozita në këto komisione.

z.Naim Çunaku, theksoi, meqë tërthorazi parafolësi u ndërlidh me diskutimin tim të mëparshëm, unë nuk u thirra në Rregulloren e punës por u thirra në arrogancën e numrave-votave të shfaqura në Kuvend.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, këtë Rregullore të punës së Kuvendit nuk e kam nxjerrë unë por e ka nxjerrë Kuvendi i Komunës, madje i nderuar zotëri Çunaku edhe në kohën kur është miratuar kjo rregullore unë kam qenë anëtar i Kuvendit të Komunës, mirëpo edhe në atë kohë me arrogancën e LDK-së është nxjerrë kjo Rregullore sepse LVV ka qenë me numra shumë të vogël, kurse ne si PDK kemi qenë me numër më të madh por që nuk na ka pyet askush. Pra i keni arritë numrat dhe këtë Rregullore të punës së Kuvendit e ka nxjerrë LDK dhe me këtë edhe tani po punojmë ne si Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, meqë përmende LDK-në tani më bënë ta marrë fjalën sërish, të thoni se një Rregullore është e një partie politike, ju sugjeroj të shfletoni procesverbalet e saj kohe dhe mund të gjeni se unë dhe ti (i drejtohet Kryesuesit) kemi qenë në një parti dhe kemi votuar për këtë Rregullore, nuk kemi qenë në LDK fare në atë kohë.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk është e vërtetë i nderuar Çunaku që unë e kam votuar këtë Rregullore, dhe për këtë edhe unë e them se mund të hyjmë në procesverbale të asaj kohe dhe e gjejmë se a kam votuar apo jo.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, nëse mendoni, dhe nëse në atë kohë e keni cilësuar si gabim të LDK-së këtë Rregullore, dhe tani atë gabim e bartni edhe tek ju, më duket jo shumë punë e mirë.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë vetëm po e them se ajo punë është bërë në atë kohë dhe është bërë me votat e juaja si LDK, andaj publikisht po e them se nuk e kam votuar në atë kohë Rregulloren e punës së Kuvendit. Po e përsërisë se mund t'i gjejmë procesverbalet dhe e shohim se unë nuk e kam votuar, andaj nuk po dëshiroj ta zgjasë më shumë këtë çështje, por vetëm dëshiroj të punoj sipas kësaj rregulloreje, ligjit për vetëqeverisje lokale dhe akteve tjera përkatëse.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë kam shpresuar shumë sepse në takimin e parë që kemi pasë ju i nderuar Kryesues keni thënë se ajo Rregullore është e vjetër dhe kam menduar se në këtë propozim planin e punës që e keni sjellë do të zë vend në një prej mbledhjeve që të ndryshohet kjo Rregullore, prandaj numrat i keni dhe urdhëroni ndryshojeni.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, meqë ju në atë kohë e paskeni konsideruar si gabim i nderuari Kryesues, atëherë a keni iniciuar plotësim ndryshimit të kësaj rregulloreje.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolëses, theksoi, në momentin që do t'i kemi numrat ne do të fillojmë me procedimin e plotësim ndryshimit të kësaj Rregulloreje.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, sa i përket numrave po shihet se i keni dhe kjo po shihet në procese të votimit.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish përgjigje parafolëses, theksoi, e nderuar ju rikujtoj se Rregullorja e punës së Kuvendit nuk bëhet me shumicë por me 2/3 e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit të Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, jo zotëri Kryesues i Kuvendit, sërish po gabon sepse Rregullorja e punës së Kuvendit miratohet me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit. E keni ngatërruar këtë me Statutin e Komunës.

Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se u konsumua kjo temë rreth Rregullores së punës së Kuvendit, andaj kalojmë me dhënien e propozimeve për anëtar të komisionit sipas kësaj pike të rendit të ditës.

z.Fitim Muçolli, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së, për komisionin në fjalë propozojmë z.Artrit Mulliqin.

znj.Mimoza Abdullahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së, për anëtar të këtij Komisioni propozojmë z.Bashkim Sylën

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëro nëse ndokush dëshiron fjalën para se të kalojmë me procesin e votimit.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së kërkojmë një pauzë prej 10 minutave.

z.Bashkim Sylë, theksoi, konsideroj se meqë jemi duke diskutuar për një pikë të rendit të ditës dhe po thuajse në mes të diskutimeve, do të ishte mirë të përfundoj kjo pikë pastaj të marrim një pauzë ashtu siç u kërkua.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, unë tërhiqem nga kandidatura për anëtar në këtë komision dhe njëkohësisht në vend timin për anëtar të komisionit në fjalë propozoj z.Kasib Bashotën.

z.Kasib Bashota, theksoi, edhe unë po ashtu tërhiqem nga kandidatura që mu bë për anëtar të komisionit të cekur dhe njëkohësisht kërkoj të propozohet një kandidat tjetër.

z.Fitim Muçolli, theksoi, edhe unë kërkoj një pauzë të shkurtër 5 deri në 10 minuta me qëllim të konsultimeve brenda grupit të këshilltarëve.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, atëherë ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV sërish kemi propozim për anëtar në komisionin përkatës, dhe ai është z.Fitim Muçolli.

z.Valon Demolli, theksoi, meqë si duket LVV nuk ka emër për të propozuar në këtë komision, atëherë ne Grupi i këshilltarëve të LDK-së e propozojmë z.Ilir Kopranin

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sqarim për parafolësin, Grupi i këshilltarëve të LVV-së veç e paraqiti propozimin e kandidatit dhe ai është Fitim Muçolli. Pastaj kemi propozimin e Grupit të PDK-së që është Bashkim Syla, si dhe propozimin e Grupit të LDK-së Ilir Kopranin.

Andaj meqë tani sërish kemi 3 kandidat të propozuar për anëtar në komision e cekur, duhet të shkojmë me votim veç e veç për secilin propozim, dhe fillojmë nga kandidati i propozuar nga radhët e Grupit të LDK-së, për të vazhduar me atë të Grupit të LVV-së dhe në fund me kandidatin e Grupit të PDK-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë 14 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike – Stacioni i Autobusëve Podujevë, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë z.Illir Koprani.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, 17 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike – Stacioni i Autobusëve Podujevë, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë z.Fitim Muçolli.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, 17 vota ishin PËR, që në kuadër të Komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike – Stacioni i Autobusëve Podujevë, nga radhët e Kuvendit të Komunës të jetë z.Bashkim Syla.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se miratohet propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike – Stacioni i Autobusëve Podujevës, përkatësisht nga radhët e Kuvendit të Komunës emërohen z.Fitim Muçolli dhe z.Bashkim Syla.

Meqë pati kërkesë për pauzë 10 minuta, Kryesuesi i Kuvendit kërkoj të ketë deklaram me votë që të shkohet në pauzë. Pas votimit u përkrah kërkesa për pauzë.

Pauzë 10 minuta, duke filluar nga ora 11;10

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 11;25,

Kryesuesi i Kuvendit vazhdoi me mbledhjen duke konstatuar kuorumin.

5. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra sikurse në dy komisionet paraprake kemi të bëjmë me ngritjen e komisionit të aksionarëve të kësaj Ndërmarrje, komision i cili ngritet prej 3 anëtarëve ku dy prej tyre i emëron Kuvendi ndërsa 1 anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, si Grup i këshilltarëve të LDK-së nuk do të propozojmë fare ngase siç u pa në dy komisionet paraprake nuk ishte vullneti që edhe ne të kemi anëtar në këto komisione.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozon z.Artrit Mulliqin.

z.Bashkim Syla, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozon znj.Endritë Muratin.

z.Burim Hasani, theksoi, nga subjekti i AAK-së nuk kemi propozim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi dy të propozuar për anëtar në komisionin në fjalë, andaj i vë në votim anëtarët e propozuar për anëtar në këtë komision.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet propozim vendimi për ngritjen e komisionit komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. Podujevë, përkatësisht nga radhët e Kuvendit të Komunës caktohen z.Artrit Mulliqi dhe znj.Endritë Murati.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kalojmë në pikën e radhës, mirëpo meqë z.Qëndrim Softolli ka kërkuar fjalën, urdhëro fjala për ju mirëpo vetëm nëse diskutimi juaj ka të bëjë me pikën e 6 të rendit të ditës, sepse këto që ishin përfunduan me diskutime.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, koalicioni qeverisës PDK – LVV, në sy të publikut i fshehur, por në Kuvend funksional me arrogancën e numrave përjashton në mënyrë të pa precedent Grupin më të madh të kuvendarëve, vullnetin më të madh të qytetarëve nga përfaqësimi qytetarë duke i lënë pa përfaqësues në organizmat vendimmarrës. Prandaj LDK, jo me vullnetin e saj, por në përballje me arrogancën e numrave përjashtohet të jap kontributin e saj, andaj me keqardhje detyrohemi të mos marrim pjesë efektivisht në punimet e kësaj seance, mirëpo do të jemi prezent fizikisht vetëm për hir të qytetarëve.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, më duket se e kemi kthyer seancën e Kuvendit në konferencë për media, kështu që ta kemi parasysh se çfarë po bëjmë.

6. Propozim për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, Komuna ka bërë publikimin e thirrjes publike për paraqitjen e kandidatëve të propozuar nga komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës në mënyrë që pastaj të paraqiten në Kuvendin e Komunës për anëtar të komitetit për Komunitete. Deri më tani janë paraqitë 4 emra të propozuar për anëtar në Komitetin për Komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës, të propozuarit janë; Albina Avdiu, Xhafer Ademi dhe Shkurte Sejdiu nga komuniteti Ashkali, si dhe Muhamet Sadiku nga komuniteti Rom.

Përveç këtyre anëtarëve të propozuar nga komunitetet jo shumicë, Komiteti për Komunitete duhet të plotësohet edhe me 3 anëtarë nga radhët e Kuvendit të Komunës, kështu që fjala për Grupin më të madh të LDK-së që të japin propozimin e tyre për anëtar në këtë Komitet.

z.Valon Demolli, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së veç u deklarua pak më parë se nuk kemi propozim.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozojmë Qëndresa Hajrizin dhe Haki Rudarin.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozojmë Mimoza Abdullahun.

z.Burim Hasani, theksoi, nga AAK propozojmë Arbnor Fazliun.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ky Komitet duhet t'i ketë 7 anëtar, kurse janë propozuar 8 anëtar, andaj na duhet që të votojmë për secilin veç e veç, dhe ata që marrin vota më shumë do të përfshihen në përbërjen e plotë të këtij Komiteti.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që e propozuara znj.Albina Avdiu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit Ashkali.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që i propozuari z.Muhamet Sadiku të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit Rom.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që i propozuari z.Xhafer Ademi të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit Ashkali.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që e propozuara znj.Shkurte Sejdiu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e komunitetit Ashkali.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që e propozuara znj.Qëndresë Hajrizi të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 17 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe 1 votë e PËRMBAJTUR, që i propozuari z.Haki Rudari të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, 18 vota ishin PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, që e propozuara znj.Mimoza Abdullahu të jetë anëtare e Komitetit për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, meqë vetëm 4 vota ishin PËR, 6 votë KUNDËR dhe 1 votë e PËRMBAJTUR, i propozuari z.Arbnor Fazliu nuk merr votat e mjaftueshme të jetë anëtar i Komitetit për Komunitete nga radhët e Kuvendit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nga votimi paraprak mund të konstatojmë se nga 8 anëtarët e propozuar, në përbërje të komitetit shkojnë 7 me numrin më të madh të votave, dhe atë; Albina Avdiu, Muhamet Sejdiu, Xhafer Ademi, Shkurte Sejdiu, Qëndresë Hajrizi, Haki Rudari, Mimoza Abdullahu. Dhe tani këtë përbërje e hedhin në votim.

Pas votimit të përbërjes së Komitetit për Komunitete sipas propozimeve dhe votimit paraprak, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa i ishin prezent në sallë, me 18 vota PËR, 2 vota KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për themelimin dhe përbërjen e Komitetit për Komunitete, në këtë përbërje;

-Qëndresë Hajrizi, anëtare nga radhët Kuvendit të Komunës

-Haki Rudari, anëtar nga radhët Kuvendit të Komunës

-Mimoza Abdullahu, anëtare nga radhët e Kuvendit të Komunës

-Albina Avdiu, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali

-Xhafer Ademi, anëtar nga radhët e Komunitetit Ashkali

-Shkurte Sejdiu, anëtare nga radhët e Komunitetit Ashkali

-Muhamet Sadiku, anëtar nga radhët e Komunitetit Rom

7. Propozim Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

- Propozim vendimi për vënien në diskutim publik

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë kemi të bëjmë me një draft Rregullore të re e cila është sjellë në Kuvend dhe për të cilën sot vetëm kërkohet që me vendim të vëhet në diskutim publik.

z.Fatum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, subvencionet janë kategori e rëndësishme buxhetore me anë të të cilave organizatat buxhetore, në këtë rast Komuna e Podujevës mbështetë financiarisht subjekte të ndryshme me synim përparimin ekonomik, arsimor, kulturorë she social

të shoqërisë tonë. Ndarja e subvencioneve kërkon rregullativë ligjore në bazë të të cilës ndahen këto subvencione në mënyrë që të sigurohet një ndarje e drejtë dhe transparente e mjeteve financiare për subjektet e ndryshme.

Komuna e Podujevës nga viti 2012 ka të aprovuar një rregullore e cila nuk është gjithë përfshirëse dhe nuk ka siguruar elemente të qarta mbi bazën e të cilave duhet të ndahen subvencionet që në këtë mënyrë të ndahet drejtësi dhe barazi në ndarjen e subvencioneve, dhe duke pasë parasysh këtë është shtruar si detyrë e domosdoshme që ta draftojmë një rregullore të re për ndarjen e subvencioneve e cila siguron gjithëpërfshirje dhe kritere të drejta për ndarjen e subvencioneve në mënyrë që të pamundësohet çfarëdo ndikimi në ndarjen e subvencioneve.

Me këtë draft rregullore përcaktohen kushtet dhe procedurat që i mundësojnë Komunës ndarjen e mjeteve financiare pa kthim nga kategoria e subvencioneve për fushat përkatëse të cekura në këtë rregullore për personat fizik dhe juridik si dhe vendosjen e sistemit transparent dhe llogaridhënës për financimin / subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve si dhe dhënies së ndihmës për nevoja të ndryshme të qytetarëve. Me këtë rregullore përcaktohen procedurat për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve në fushën e arsimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, kulturës rinisë dhe sportit, pastaj subvencione për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për familjet me vendbanim në territorin e Komunës së Podujevës si dhe subvencione për mbulimin e qirasë së banimit.

Meqë sot jemi duke diskutuar vetëm për aprovim nga ana e Kuvendit të Komunës të draftit të rregullores për ndarjen e subvencioneve e që në bazë të proceduarve kërkohet që ky draft të kalojë në diskutim publik për 30 ditë, kohëzgjatje kjo brenda së cilës do të organizohen debate publike, ju ftoj të gjithëve ta mbështetni këtë draft rregullore dhe njëherit ju ftoj të jepni kontributin e juaj përgjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në mënyrë që në fund ta kemi një rregullore sa më të drejtë dhe sa më të kompletuar. Natyrisht se për këtë rregullore do të ketë diskutime të ndryshme për fushat që i parasheh kjo rregullore, diskutime të cilat do të mbahen për sport, kulturë, arsim, ekonomi, për bujqësi si dhe diskutime për të gjitha sferat tjera dhe gjithsesi do të jetë një diskutim publik i hapur për të gjithë qytetarët e që si datë për këtë diskutim e kemi paraparë 22 marsin 2022, duke filluar nga ora 16:00. Propozojmë që periudha e diskutimit publik pra të jetë 30 ditë, dhe atë nga data 04 mars 2022 deri më 04 prill 2022.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, fillimisht më lejoni që në emrin tim të falënderoj çdo qytetar që ma besoj votën e tij dhe që më mundësojë të jem sot këtu dhe t'i përfaqësoj ata në Kuvendin e Komunës. Për këtë që e ceka kërkoj mirëkuptim sepse është fjalimi im i parë këtu.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës që është draft rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, nga përvoja e të kaluarës them se kjo rregullore është shumë e nevojshme për tu vë në diskutim publik dhe njëherë e mirë të rregullohen dhe përcaktohen kriteret e duhura për subvencionim dhe të përmirësohen apo të largohen disa kritere që kanë ekzistuar më parë por që kanë qenë diskriminuese për shumë kënd.

Përmes kësaj rregulloreje bëhet e mundur të eliminohen parregullsitë që kanë ndodhur viteve të kaluara, po ashtu përmes kësaj eliminohet mundësia që një person të përfitoj përherë kurse të tjerët asnjëherë, pra thënë ndryshme i është dhënë vijë e kuqe monopoleve të krijuara më parë ku vetëm një grup i personave kanë përfituar nga subvencionet, kësi soji kjo rregullore përkujdeset që të gjithë ata të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Duke marrë për bazë materialin / dokumentin që kemi pranuar, unë kam disa sugjerime të cilat do t'i theksoj shkurtimisht këtu por të cilat patjetër do t'i potencoj edhe gjatë fazës së diskutimit publik, dhe atë, paragrafi 4 i nenit 6 ku thuhet se *nëse përfituesit nuk përmbushin obligimet e përcaktuara në vendimin apo në marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve, për tri vitet e*

*ardhshme përfituesi humb të drejtën për përfitim nga secila kategori e subvencioneve, këtu duhet pasur parasysh që përfituesi mund të mos i plotësoj obligimet për shumë arsye dhe që duhet të merret parasysh arsyeja para se të pezullohet e drejta për të përfituar, ka shumë raste ku përfituesi mund të mos i plotësoj kriteret e cekura më parë siç është rasti i mbulimit të participimit në shumë prej 30% të shumës së subvencionit, dhe që përfituesi mund të pësoj prej ndonjë fatkeqësie të ndryshme dhe si pasoj e kësaj mund të mos ketë mundësi të paguaj pjesën e tij financiare prej 30%, andaj do të ishte shumë e padrejtë të pezullohet e drejta që për tri vitet e ardhshme të mos përfitoj ndonjë subvencion nga Komuna, prandaj kërkoj që të merret parasysh ky argument dhe propozoj të ndryshohet si në vijim; *Obligimet e përcaktuara në marrëveshjen për ndarjen e subvencioneve nëse nuk përmbushen nga mos përgjegjësia e përfituesit, me përjashtim të ndonjë fatkeqësie, për tri vitet e ardhshme përfituesi humb të drejtën në përfitim nga secila kategori e subvencioneve.**

Po ashtu kemi nenin 13 ku propozoj të shtohet edhe një paragraf, si në vijim; *marrëveshja duhet të nënshkruhet në afat prej 15 ditësh kalendarike pas shpalljes së vendimit për ndarjen e subvencioneve, në mënyrë që të përcaktohet sakt periudha se kur duhet të rregullohet me një marrëveshje mes dy palëve dhe jo të zgjatet nënshkrimi i një marrëveshje nga cilado palë qoftë dhe për çka do qoftë arsye. Mandej kemi nenin 15 që përcakton kriteret që nevojiten për ndarjen e bursave studentore e që mendoj se duhet të shqyrtohet mundësia e shtimit edhe të një kriteri tjetër ku thuhet; *studenti apo nxënësi i cili ka arritur sukses në gara të ndryshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe që nuk ka përfituar subvencion sipas nenit 14 paragrafët 1.6 dhe 1.8 të ketë vlerësim shtesë prej 5 pikëve, dhe rrjedhimisht tek ky nen paragrafi 2 te dokumentet që kërkohen për bursë të shtohet një kriter tjetër po ashtu që të kërkohet dëshmi për rezultatet në gara. Për fund, ne si Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim dhe mbështesim propozimin që ky vendim të vëhet në diskutim publik.**

znj.Endritë Murati, theksoi, në rend të ditës kemi sot kemi për diskutim dhe eventualisht për aprovim të vendimit të një akti normativ shumë të rëndësishëm që është propozim rregullorja për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Fillimisht kur e pash rendin e ditës mendova që bëhet fjalë për një akt zbatues të Komunës për zbatimin e Rregullores MF nr.04/2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve e nxjerrë nga Ministria e Financave, mirëpo gjatë shqyrtimit të përmbajtjes së propozim rregullores së cekur që është bashkëlidhur me material dhe dispozitave tjera, vërejta se bëhet fjalë që çështjet e njëjta i rregullojnë ndryshe nga Rregullorja 04/2017 pavarësisht se në dispozitën e qëllimit dhe fushëveprimit nënvizohet edhe procesi i ndarjes së subvencionimeve i nënshtrohet parimeve e dispozitave të përgjithshme dhe të veçanta të Rregullores 04/2017. Dua të shprehë përkrahjen time në parim për domosdoshmërinë e hartimit të rregullave dhe procedurave të qarta që rregullojnë segmentin e shpërndarjes eficiente të përkrahjes financiare për mbështetjen e iniciativave dhe projekteve të sektorit jo qeveritar ose civil, por do të bëja një thirrje për Ekzekutivin e Komunës që e ka hartuar këtë propozim të aktit normativ që të ketë kujdese dhe të zhvilloj konsultime shteruese me nivelin qendrorë, konkretisht me Ministrinë e Financave në mënyrë që të mos kemi akte normative në fuqi që kundërshtojnë njëra tjetrën për probleme të njëjta me çka vështirësohet zbatueshmëria e akteve normative dhe krijohen rrethana për kontestim të proceseve të domosdoshme për realizimin e orientimeve programore të Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, kërkesa për sjelljen e një rregulloreje të tillë ka qenë e kamotshme, dhe shumë mirë dhe është pozitive që tani kemi një draft rregullore e cila pasi të kryej procedurat e diskutimit publik do të sjellët për aprovim në këtë Kuvend, por ajo që dua ta them unë është se draft rregullorja parasheh subvencionime në 5 fusha, dhe atë; në arsim, shëndetësi, zhvillim

ekonomik, bujqësi si dhe në kulturë rini dhe sport, prandaj duke u nisur nga kjo dhe duke ditur se është një rregullore shumë e rëndësishme në zbatim, sidomos po nisem në fushën prej nga vijë unë që është fusha e arsimit, do të ishte mirë që në datat që drejtori i DBF-së i ceku në fjalën hyrëse të ndaheshin ngase mendoj se është ngarkesë e madhe në rast se për gjitha këto fusha mbahet vetëm një diskutim publik në datën e caktuar që e paraqiti drejtori i DBF-së, andaj propozoj që në mënyrë që të jetë më i frytshëm diskutimi publik datat e diskutimeve të ndahen sipas fushave, shembull, për arsim, kulturë dhe rini të jetë një diskutim i veçantë, kurse për fushat tjera të jetë një diskutim tjetër i veçantë. E them këtë sepse më duket paksa çështje e ngarkuar dhe e madhe që gjitha këto 5 fusha të përfshihen vetëm në një diskutim publik dhe vetëm në një datë, e që më duket se është e tepërt, por konsideroj se do të ishte mirë që të kemi të paktën 2 data të diskutimit publik, dhe atë, një datë ku do të përfshihen arsimi, kultura, rinia dhe sporti, dhe një datë tjetër ku do të përfshiheshin shëndetësia, zhvillimi ekonomik dhe bujqësia në mënyrë që sa do pak të ketë sa më shumë të interesuar të marrin në diskutime publike, mirëpo në të njëjtën ditë të vijnë të interesuarit për të gjitha fushat mendoj se është e tepërt.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, vetëm dëshiroj të jap dy sqarime rreth diskutimeve të dy këshilltarëve të respektuar parafolës. Sa i përket Rregullores së Ministrisë së Financave përmes së cilës subvencionohen OJQ-të, normalisht se kudo që Komuna subvencionon është e obligueshme që të zbatoj atë Rregullore të Ministrisë, mirëpo në këtë rast kemi të bëjmë me rregulloren komunale e cila nuk ka të bëjë me subvencionimin e OJQ-ve. Rastet kur ceket se Komuna subvencionon edhe OJQ-të, por çdo herë kur bëhen thirrjet publike për OJQ-të e kemi obligim ligjor dhe normalisht do t'i referohemi Rregullores së Ministrisë së Financave nr.04/2017 që rregullon mënyrën e subvencionimit të OJQ-ve, mirëpo rregullorja komunale kompletion edhe fushat tjera siç kemi shembull fushat e bujqësisë, ekonomisë, arsimit e t të tjera të ngjashme që nuk kanë të bëjnë fare me OJQ e që domosdo do të na duhet të punojmë me këtë rregullore të re e cila ka qenë domosdoshmëri dhe kemi bërë përpjekje maksimale që këtë draft ta hartojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, mirëpo sigurisht që jemi shumë të hapur për diskutime dhe propozime që do të mund të bëhen gjatë gjithë kësaj kohëzgjatje të diskutimit publik, dhe normalisht se këto diskutime nuk bëhen vetëm me diskutime publike, mirëpo në çfarë do forme që vijnë ato propozime ne do t'i marrim parasysh me qëllimin e vetëm që në fund ta kemi një rregullore sa më të mirë të mundshme si dhe të kemi edhe transparencë, edhe ndarje të drejtë edhe politika të mira të subvencionimit.

Sa i përket asaj që e ceku asambleisti z.Haki Rudari, pa dyshim se do të mbahen disa diskutime dhe kjo çështje ceket edhe në propozim vendimin përkatës, dhe në këtë aspekt ne do të mbajmë diskutime të ndara, veçmas në fushën e kulturës, veçmas në shëndetësi, për bujqësi, për ekonominë si dhe për fushën e arsimit, mirëpo përveç këtyre diskutimeve publike sektoriale, do të jetë edhe një diskutim i përgjithshëm për të cilin unë veç e përcaktova datën, vendin dhe kohën. Normalisht që përmes ueb faqes zyrtare të Komunës do të bëjmë thirrjen / njoftimin për këto dëgjime publike për secilin sektor dhe në fund një diskutim i përgjithshëm që do të mbahet më 22 mars të këtij viti.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë jeni në dijeni se kjo draft rregullore duhet të kalojë në diskutim publik dhe për këtë duhet ta marrim një vendim ashtu siç ju është dërguar me materialin përkatës, andaj e vë në votim propozim vendimin për vënien në diskutim publik të draft Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, përfshirë edhe propozimin e drejtorit të DBF rreth kohëzgjatjes së diskutimit publik si dhe datës së diskutimit të përgjithshëm publik.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, përfshirë edhe propozimin e drejtorit të DBF që kohëzgjatja e diskutimit publik të zgjat 30 ditë, nga 04 mars 2022 deri më 04 prill 2022, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 22 mars 2022 duke filluar nga ora 16:00, dhe çështjeve tjera sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

8. Propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës

- Propozim vendimi për vënien në diskutim publik

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, paravetës keni një propozim vendim për vënie në diskutim publik një propozim rregullore për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës, rregullore kjo e hartuar edhe gjatë vitit që lam pas, mirëpo meqë kemi të bëjmë vetëm me vënien e të njëjtës në diskutim publik po e paraqes propozimin për kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe datat e debatit publik, pra kohëzgjatja e diskutimit publik të jetë nga data 04 mars 2022 deri më 04 prill 2022, data e debatit publik me qytetar të jetë më 15 mars 2022 në ora 11:00, kohëzgjatje gjatë së cilës presim sugjerime, vërejtje dhe propozime të ndryshme.

z.Ragip Fetahu, theksoi, fillimisht falënderoj gjithë qytetarët për mbështetjen që më kanë dhënë gjatë procesit zgjedhor dhe njëkohësisht i përgëzoj ata për votëbesimin e dhënë për Lëvizjen Vetëvendosje dhe profesorin z.Shpejtim Bulliqi, e që besoj se ky Ekzekutiv i Komunës do të jetë mjaftueshëm i zoti të zgjidh problemet tona duke u bazuar në atë që në Ligjin për vetëqeverisje lokale njihet si parimi i subsidiaritetit.

Krahas Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT nr.03/2016 si dhe ligjeve tjera në fuqi është nevojë e kohës që Komuna jonë të ketë një rregullore për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore dhe kjo bazohet në praktikën më të mirë të Komunave tjera të Kosovës siç është ajo e Komunave të Gjakovës dhe Rahovecit.

Rregullorja e propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht nga Drejtoria e Arsimit ndihmon procesin edukativo arsimor në Komunën tonë duke filluar nga menaxhimi i brendshëm i institucioneve arsimore, organeve përfaqësuese dhe profesionale, të drejtat detyrat dhe obligimet e tyre, personelit si dhe të nxënësve e deri te masat disiplinore për nxënësit, edukatorët dhe jo vetëm, po ashtu ndalon diskriminimin në raport mësimdhënës-nxënës mbi baza etnike, vendbanimi apo gjinie si dhe sanksionon me masa të qarta nxënësit delikuent dhe konfliktuoz.

E veçanta e kësaj rregulloreje është sepse ndëshkon propagandat fetare dhe politike brenda institucioneve edukativo-arsimore në Komunën tonë, por nga ana tjetër kjo rregullore ka edhe disa elemente të cilat duhet të plotësohen gjatë procesit. Ku jemi tek ndërrimi i shkollës për nxënësit që bëjnë probleme serike nuk theksohet mënyra se nga kush dhe si mund të bëhet kjo andaj konsideroj se patjetër kjo çështje duhet të detajizohet për shkak se kërkesat e tyre mes drejtorëve në shkollave nuk realizohen në mungesë të vullnetit të pranimit të atyre nxënësve problematik nga shkollat tjera. Për fund ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim rregullore që e njëjta të kalojë në fazën e diskutimit publik.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne si Grup i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për vënien e propozim rregullores së cekur në diskutim publik, ndërsa kontributin tonë do ta japim në fazat e diskutimit publik.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin përkatës duke përfshirë edhe propozimin e drejtorit të DKA-së rreth kohëzgjatjes së diskutimit publik dhe datës së debatit publik, përkatësisht që e njëjta t'i nënshtrohet diskutimit/debateve publike para se të sjellët sërish në Kuvend për shqyrtim dhe miratim final.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për vënie në diskutim publik propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës, përfshirë edhe propozimin e drejtorit të DKA që kohëzgjatja e diskutimit publik të zgjat 30 ditë, nga 04 mars 2022 deri më 04 prill 2022, kurse debati publik me qytetarë të mbahet më 15 mars 2022 duke filluar nga ora 11:00, dhe çështjeve tjera sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

9. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, rreth kësaj pike kemi të bëjmë me propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës. Është fat i mirë që jetësimet dhe premtimet e Kryetarit të Komunës z.Shpejtim Bulliqi po realizohen dhe është një fat i mirë që edhe qytetarët, mirëpo edhe për ne si Ekzekutiv i Komunës që po realizohen këto projekte të premtuara.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim dhe mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në qytetin e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

10. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë

z.Artrit Mulliqi, theksoi, duke pasë parasysh që fshati Batllavë është njëri nga fshatrat me më së shumti banorë në Komunën e Podujevës dhe duke parë nevojat e këtij fshati dhe fshatrave përreth për një Çerdhe, ne Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim propozim vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 33 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 18 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit - Çerdhe publike në fshatin Batllavë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

11. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, gjithashtu edhe për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sipas Udhëzimit Administrativ 151/2020 procedurat e kërkojnë kështu që të sjellët në Kuvendin e Komunës propozim vendimi përkatës me emrat e anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore. Ne i kemi propozuar këta emra dhe janë Blerim Vllasa i cili është zyrtar i lartë në Drejtorinë e Arsimit dhe Nazif Sheqa kryetar i Këshillit të prindërve në nivel komunal, kurse përfaqësuesin e MASHT e dërgon me kohë Ministria e Arsimit ashtu siç është vepruar edhe në vitin e kaluar.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrah këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për ngritjen e komisionit për përzgjedhës për drejtorë dhe zëvendës drejtor në institucionet publike edukativo arsimore në Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

12. Propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jemi në dijeni se është një sasi e druve që janë të konfiskuara nga Inspektorët dhe Policia për shkak të prerjes së tyre në mënyrë të paligjshme, dhe këto dru duhet t’iu jepen familjeve në nevojë, aq më shumë që tani jemi në sezonin e dimrit, kështu që ky propozim është sjellë në Kuvend nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe për këtë fjalën e ka drejtori i kësaj Drejtorie.

z.Fatmir Rudari, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – DBPZHR, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, fillimisht meqë është hera e parë që jam pjesëmarrës në këtë legjislaturë, uroj të gjithë anëtarët/et e Kuvendit për mandatin e marrë në këtë përbërje të Kuvendit.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës kemi të bëjmë me një propozim vendim lidhur me një sasi të konsiderueshme të masës drusore e cila ndodhet në fshatin Peran, përkatësisht në deponin e caktuar aty, masë drusore e cila është e konfiskuar nga Policia e Kosovës së bashku me DBPZHR për shkak të prerjes së tyre në mënyrë ilegale.

Vlen të ceket se DBPZHR ka tentuar në 4 raste që këtë masë drusore ta shes përmes Zyrës së prokurimit por në asnjë rast nuk ka pasë të interesuar që të konkurrojnë për blerjen e kësaj mase drusore dhe tani nevoja ka qenë që t’i paraqitet Kuvendit të Komunës pasi që kjo masë dita-ditës e humb sasinë dhe se ka afërsisht 3 vite që ndodhet në atë deponi, prandaj edhe i’u kemi paraqitur Kuvendit të Komunës me këtë kërkesë për miratimin e propozim vendimit që ajo sasi e druve t’iu ndahet familjeve në nevojë, pasi që për këtë ka edhe kërkesa të mëdha të qytetarëve që të pajisen me këto dru. Nëse kërkohej sqarime shtesë jam i gatshëm t’ju jap gjatë diskutimeve.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së ne e përkrahim këtë propozim vendim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahim këtë iniciativë dhe shpresojmë që gjatë shpërndarjes Komisioni përkatës do të bëjë përzgjedhjen e atyre familjeve që e miratojnë t'i shpërndahen dru.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 20 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

13. Propozim vendimi për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë çështje kemi kërkesë prej Asociacionit të Komunave të Kosovës-AKK që të caktohen anëtarët e Komunës së Podujevës për përfaqësim në Kuvendin e AKK, kështu që përveç Kryetarit të Komunës i cili është përfaqësues sipas pozitës zyrtare, nga Kuvendi i Komunës duhet të caktohen edhe 4 anëtar tjerë. Pra duhet të jepen propozimet e emrave dhe ju ftoj të merrni fjalën.

z.Florent Hasani, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së propozohen Ardi Hasani dhe Xhevdet Maloku.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së propozohet Hilmi Hoxha i cili njëkohësisht është edhe Kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, meqë askush nuk kërkoi fjalën, theksoi, ka mbet edhe një anëtar për t'u propozuar andaj urdhëroni.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë Mrika Thaçin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, ju sqaroj se përveç Kryetarit të Komunës i cili përfaqëson Komunën sipas pozitës, kemi edhe 4 anëtar të propozuar, andaj e hedh në votim propozimin vendimin përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, sipas propozimeve të cekura.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 18 vota PËR, 2 vota KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për përfaqësim të Komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, me anëtarët si në vijim:

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës

z.Ardi Hasani, anëtar nga Kuvendi i Komunës

z.Xhevdet Maloku, anëtar nga Kuvendi i Komunës

znj.Mrika Thaçi, anëtare nga Kuvendi i Komunës

14. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018

znj.Bahrije Mehmeti, drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, ky propozim vendim është sjellë para Kuvendit të Komunës në atë mënyrë që siç ka qenë sipas vendimit përkatës i vitit 2018, të ridestinohet në objekt dhe hapësirë që mund të jepet në shfrytëzim për qëllime afariste, hoteliere, shëndetësore, rekreative sportive dhe veprimtari tjera të ngjashme të interesit të përgjithshëm, në mënyrë që vendimi i vitit 2018 të mos kufizohet vetëm në veprimtari të cilat kanë qenë të parapara, mirëpo t’iu mundësohet bizneseve që edhe për veprimtari tjera ta marrin objektin në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 17 vota PËR, 2 vota KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimi nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar në Kuvendin e Komunës së Podujevës më datë 02 nëntor 2018, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

15. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ky propozim vendim ka hyrë si pikë shtesë e rendit të ditës në mbledhjen e KPF-së dhe i është rekomanduar Kuvendit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si dhe shqyrtimin e tij. Po ashtu edhe sot me rastin e miratimit të rendit të ditës kjo pikë u mbështet që të përfshihet në rend të ditës, andaj fjalën ja jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave si propozues i këtij vendimi.

z.Fatlum Osmani, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në vitin 2020 është nënshkruar një Marrëveshje Mirëkuptimi mes Komunës së Podujevës dhe Kompanisë “Pastrimi” në mënyrë që të gjitha Komunitatet që janë pjesë e kësaj Kompanie duke përfshirë këtu edhe Komunën e Podujevës ta mbështesin financiarisht Ndërmarrjen “Pastrimi” për realizimin e disa investimeve të cilat kanë qenë të domosdoshme për këtë Kompani, si për ndërtim të objektit, pajisje për pastrim e të tjera të ngjashme, dhe në kuadër të kësaj Marrëveshje ka qenë një zotim i Komunës së Podujevës për mbështetje në shumë 100,000.00€.

Dihet se ky subvencionim duhet të bëhet nga kategoria e subvencioneve të Komunës së Podujevës dhe duke pasqyruar parasysh që si Komuna kemi kufizime të mjeteve buxhetore posaçërisht në kategorinë e subvencioneve nuk kemi pasqyrë mundësi që ta realizojmë këtë zotim në shumë prej 100,000.00€, mirëpo kemi propozuar që Kompania “Pastrimi” të subvencionohet me një shumë prej 20,000.00€ dhe për këtë kërkojmë që ta miratoni si Kuvend i Komunës.

z.Bahri Blakçori, theksoi, pas sqarimeve të bëra nga drejtori i DBF-së, në e Grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 17 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare Ndërmarrjes Publike – Kompania regjionale e Mbeturinave - KRM “Pastrimi” sh.a., sipas propozimit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

16. Propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e paraqiti propozim planin e punës së Kuvendit, theksoi, parimisht me planin e punës së Kuvendit fillohet në fillimvit, kështu që është dashtë të miratohej në muajin dhjetor të vitit të kaluar mirëpo jemi në dijeni se kanë qenë zgjedhjet dhe po ashtu deri sa janë zgjedh drejtorët e Drejtorive ka kaluar një periudhë kohore e që pa pasur konsultime me drejtorët nuk kemi mund ta përgatitim planin e punës së Kuvendit, prandaj me emërimin e drejtorëve ku disa prej tyre kanë qenë edhe pjesë e Grupit punues për hartimin e këtij propozim plani i cili është hartuar bashkërisht dhe i është propozuar Kuvendit për miratim.

Ky propozim plan është përcjellë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i është dërguar përmes e-mailit gjithë këshilltarëve të Kuvendit, andaj nëse ndokush ka vërejtje mund t’i paraqet ato, por ne jemi që ky propozim plan i punës të miratohet.

z.Ragip Fetahu, theksoi, jam i vetëdijshëm se ky plan i punës mund edhe të ndryshoj gjatë procesit ku mund të shtohen apo të hiqen pika të ndryshme në kuadër të rendit të ditës, mirëpo ajo që më ka rënë në sy e që ndoshta është një lëshim i vogël që ka ndodh nga Komiteti për Politikë dhe Financa, sidomos nga kolegët që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar të Kuvendit, ka të bëjë me një rregullore e cila ka kaluar dëgjimet publike dhe e cila ka të bëjë me themelimin e këshillave të fshatrave për që nuk figuron askund në këtë plan, andaj sa e vërejta në muajin maj janë vetëm 4 pika të parapara të rendit të ditës kështu që propozoj që ajo rregullore të futet në kuadër të planit të punës dhe atë në muajin maj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim planin e punës së Kuvendit për vitin 2022 sipas materialit përkatës të dërguar përfshirë edhe propozimin e parafolësit.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 34 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 19 vota PËR, asnjë votë KUNDËR dhe asnjë votë e përmbajtur, miratohet propozim plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2022, sipas propozimit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, përfshirë edhe propozimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z.Ragip Fetahu, që në kuadër të planit, në muajin maj 2022 të përfshihet edhe - Propozim rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

17. Të ndryshme

znj.Drita Pajaziti, theksoi, më lejoni që në këtë pikë të propozoj që ne gratë e Kuvendit të Komunës së Podujevës ta formojmë Grupin Joformal të Grave Asambleiste dhe për këtë ftoj grat që janë pjesë e këtij Kuvend që ta mbajmë një takim të premtën në ora 12;00 këtu në Komunë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues kam një pyetje për Kryetarin tuaj të Komunës, sa ishte pika e rendit të ditë për pronat, Kryetari nuk erdhi në mbledhje, por deshta ta dije që prona e tij e cila është me një vendim të Gjykatës si e uzurpuar, a e ka qitë në listë apo jo sepse deshta të konkurroj për ta marrë unë në shfrytëzim atë pronë meqë është pronë shtetërore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vetëm dua t'i them parafolësit se Kryetari nuk është vetëm Kryetar i imi i Komunës por është Kryetar i të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, falënderoj shumë këshilltarët e Kuvendit të Komunës për racionalitetin që treguan sot në këtë mbledhje të Kuvendit me këtë numër të madh të pikave të rendit të ditës, e në veçanti më lejoni të falënderoj opozitën për kontributin e çmueshëm që e dha gjatë kësaj seance por edhe për faktin që të gjitha këto pika të rendit të ditës të cilat sot kaluan dhe u miratuan janë pika të cilat drejtpërsëdrejti prekin interesin qytetar, prandaj të gjithë ne jemi në dijeni se gjithë ju si asambleistë bashkë me neve si Ekzekutiv jemi këtu që të shërbejmë në të mirë të qytetarëve, prandaj edhe ju falënderova.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë nuk e mora përgjigjen, Kryetari filozofoj por unë përgjigje nuk mora. Ekziston një vendim i Gjykatës që ky jeton në një pronë të uzurpuar, në këtë materialin që na është dërguar për pronat që planifikohen të lëshohen me qira, prona e tij nuk figuron. Deri sa Kryetari nuk ishte prezent unë nuk deshta që pyetjen t'ia bëjë drejtoreshës së Drejtorisë përkatëse, mirëpo me që Kryetari erdhi në mbledhje pastaj unë deshta ta pyes a e ka qitë atë pronë për t'u jap me qira dhe a i paguan shtetit ndonjë gjë që jeton në pronë të uzurpuar, prandaj meqë është këtu prezent do të doja një përgjigje.

Përndryshe unë kam pronë të mjaftueshme për ta punuar se ma ka lanë gjyshi, madje në tokë të uzurpuar dhe "me re" unë nuk hy dhe nuk kaloj andej e lëre më ta punoj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, është mirë të mos hyhet në këtë temë sepse nuk ka asgjë prej asaj pune, madje ju LDK-ja e keni shterë këtë pyetje.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues, kur e përmende LDK-në nuk më intereson për të tjerët çka kanë thënë, mua më intereson të marrë përgjigje për pyetjen që i bëra.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, i nderuar Kryesues, në pikën të ndryshme nuk lejohet kështu replika dhe debate të gjata, kështu që mund ta vazhdojmë.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12;30

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0014581/22

Podujevë,

28 shkurt 2022

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha